



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES  
FAKULTETI I INXHINIERISE ELEKTRIKE  
DEKANATI

Nr. 502 Prot.

Tirane me 17.12.2018

Vendim nr. 100

date 17.12.2018

Dekanati i Fakultetit të Inxhinjerise Elektrike, ne mbledhjen e dates 17.12.2018, mori ne shqyrtim kerkesat e studenteve me nr.prot.402, date 15.12.2018 drejtuar dekanatit te FIE.

Pasi shqyrtoi kerkesat Dekanati ne unanimitet

**Vendosi:**

- 1.- Te mbeshtese protesten e studenteve dhe te ndihmoje ne zgjidhjen institucionale te 8 (tete) kerkesave te tyre.
- 2.- Te mbeshtese kerkesat e studenteve te FIE-se si te drejta duke krijuar strukturat e nevojshme dhe planin e masave per realizimin e tyre si me poshte vijon:
  - a.- Deri ne formimin institucional te Keshillit Studentor, nje perfaqesi e studenteve te FIE-se me tre anetare, do te marre pjese ne mbledhjet e dekanatit te FIE per te ndjekur nga afer realizimin e kerkesave te tyre dhe per te bashkepunuar per realizimin e zgjidhjeve te tyre. Ky vendim te hyje ne fuqi menjehere.
  - b.- Te krijohet nje grup pune, ne perberje te te cilit te jene drejtuesit e departamenteve ose perfaqesues te tyre, per shqyrtimin e verejtjeve per pedagoge te caktuar. Pas shqyrtimit, grupi i punes do ti dergoje relacion me shkrim Dekanatit, i cili do te rekomandoje rast pas rasti masat qe duhen marre ne funksion te permiresimit te procesit mesimor.
  - c.- Sekretaria mesimore te vendose menjehere orare per veprimtarine e saj ne sherbim te studenteve.
  - d.- Orari i provimeve do te publikohet 3-4 jave perpara sezonit te provimeve.
  - e.- Te filloje menjehere perditesimi i faqjes se internetit te FIE, ku te perditesohen CV-te e personelit akademik te FIE, planet mesimore te programeve te studimit si dhe syllabuset, njoftimet, etj., per ta bere ate sa me funksionale dhe te lehte per tu perdorur. Ne kete proces do te ndihmojne edhe studentët. Te pajiset çdo lende me leksione te shkruara ose libra mesimore ne gjuhen shqipe deri ne fund te ketij viti akademik.
  - f.- Te mbeshteten pedagoget nga ana financiare per perkthimin dhe shtypshkrimin e librave baze, ne gjuhe te huaja, ne lendet ku mungojne librat mesimore ne gjuhen shqipe.
  - g.- Te shikohet mundesia per te shtuar numrin e lendeve me zgjedhje per vitin e ardhshem akademik si dhe numrin e laboratoreve dhe punes praktike, gjithmone duke respektuar strukturen mesimore.
3. Te mbeshtese studentet ne kerkesat e tyre drejtuar Rektorit, Senatit Akademik te UPT, Administratorit te UPT dhe Bordit te Administrimit te UPT si me poshte:

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4. Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al

- a.- Te pergjysmohen tarifat e studimeve ne ciklin e pare dhe te dyte.
  - b.- Te permiresohen rrenjesisht kushtet ne ambientet mesimore duke filluar me mobilimin e tyre per te krijuar kushte normale pune dhe sistemin e kondicionimit.
  - c.- Sallat e leksioneve te pajisen me sistem audio.
  - d- Te ngrihet laborator i ri i kompjuterave, per te cilin jane kompjuterat, i cili duke filluar nga muaji janar 2019 te jete funksional.
  - e.- Duke filluar nga semestri i dyte te mos vendosen ne orar te mesimeve ambientet e katit nen toke.
  - ë.- Te kerkohet nga rektorati qe nje punonjese e Bibliotekes se UPT te vije ne biblioteken e FIE ne menyre qe biblioteka te funksionoj gjithë ditën për studentet.
  - f. Te pasurohet biblioteka e fakultetit me literature bashkekohore per mesimin dhe punen kerkimore shkencore.
  - g. Te behet abonimi si fakultet dhe institucion ne revista periodike shkencore prestigjioze dhe literature on line.
  - gj.- Te behet abonimi ne e-library për fushat që mbulon FIE, për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nivelin e punës kërkimore duke përfshirë sa më shumë studetë në të.
  - i. - Te filloje menjehere dixhitalizimi i librave mesimore ne vite me autore profesoratin e FIE-se ne vite, duke respektuar parashikimet ligjore mbi te drejten e autorit
  - j.- Projektbuxheti per vitin 2019 te përqëndrohet tek blerja e pajisjeve laboratorike dhe librave.
  - k.- Te realizohet urgjentisht transparenca financiare e Fakultetit dhe Universitetit per tre vitet e fundit.
- 4.- Te mbeshtese studentet ne kerkesat e tyre drejtuar Rektorit, Senatit Akademik te UPT, Administratorit te UPT dhe Bordit te Administrimit te UPT si me poshte:

- a.- Te filloje menjehere procedura per ngritjen e Keshillave te Studenteve.
- b.- Te filloje menjehere procedura per ngritjen e Keshillit te Etikes.
- c.- Te sigurohet funksionaliteti i Drejtorise te Sigurimit te Brendshem te Cilesise.
- d.- Te realizohet menjehere Rrjeti Akademik Shqiptar.
- e.- Te ngrihet menjehere Qendra e Karrieres per tu vene ne sherbim te studenteve.

Vendimi i Dekanatit te FIE i analizon dhe u jep rrugen e zgjidhjes te gjithë kerkesave te drejta te studenteve te FIE, duke i perfshire studentet si pjese shume e rëndësishme e realizimit te tyre.

Ky vendim i Dekanatit te FIE, i marre ne bashkepunim te plote me studentet e FIE ti dergohet Rektorit dhe Administratorit te UPT si dhe te behet publik ne faqen e FIE.

Bashkengjitur kerkesa e studenteve te FIE, Nr. 402, date 15.12.2018 drejtuar Dekanatit te FIE.

### Dekanati i FIE

Prof. Dr. Orion Zavalani

Prof. Dr. Aida Spahiu

Prof. Asc. Marialis Çelo

Prof. Asc. Genci Sharko

Dr. Aulon Shabani

Msc. Edlira Melo